

PROCEVERBAL

- I mbajtur sot më datë 30.04.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 14 vota pro.
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 26.03.2025 me 12 vota pro dhe 2 kundër
- Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:

1. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha mars 2025”.
2. **P/Vendim** “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në infrastrukturën e bashkisë Librazhd për projekt buxhetin afatmesëm vitin 2026-2028”.
3. **P/Vendim** “Për miratimin e kalendarit të Konsultimeve Publike për draft Tavanet Buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.

4. Të ndryshme:

Fillimi I mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha mars 2025”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

P/Vendim nr 2 “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në infrastrukturën e bashkisë Librazhd për projekt buxhetin afatmesëm vitin 2026-2028”.

Fjalën e merr këshilltari Zenel Bahiti.

Shikoj shumë investime me vlera të mëdha, kemi shpezuar shumë lekë në lidhjen me mbledhjen e pishave dhe po të shikosh në terren shume pisha janë tharë dhe në shume vende nuk ka fare.

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Po të shikoni këto investime shikojmë që vlera që kemi miratuar për keto investime ka ndryshuar. Janë rritur me vlera shumë të mëdha duhen shikuar dhe njëher nga Drejtoria perkatëse.

Fjalën e merr këshilltarja Fatbardha Qatja.

Si janë ndarë në vite këto investime?

Fjalën e merr Specialisti zyrës Xhemal Bozhiqi për të sqaruar pyetjen.

Këto janë investime që janë parashikuar dhe vlera e saktë e një investimi del kur ka projektin dhe preventivin përkatës dhe keto investime nuk ndahen në vite .

Fjalën e merr Kryetari I Këshillit Mitat Biçaku.

Këto janë investime që bashkia I ka prioritet për vitet 2026-2028 dhe kjo listë është e hapur dhe secili nga këshillatrët le të shprehë mendimet e veta dhe të shtoj investime.

Fjalën e merr këshilltari Bujar Vreto.

Shumë mire që ka investime për qytetin tonë por keto investime e kanë problemin të cilësia e punimeve. A mbane kush përgjegjësi për keto punime që kryhen se shikojmë shumë rrugë akoma pa mbushur vitin kanë filluar të prishen? Ne si KB a duhet ta ngrejme zerin për keto investime që behen me këtë cilësi?

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Në këtë mbledhje duhet të merrte pjesë Kryetari I Bashkisë për të na sqaruar më mirë për vlerat përkatëse për çdo investim. Shikoj që për izolimin e shkollave është vlera 50 milion leke të vjetra. A del kjo shifer për izolimin e të gjitha shkollave?

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 12 vota pro dhe 2 kundër.

P/Vendim nr 3 “Për miratimin e kalendarit të Konsultimeve Publike për draft Tavanet Buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU

